

Korniza e Politikave Publike

Si të arrihet deri te arsimi i integruar i mirëfilltë në Republikën e Maqedonisë?

Mr. Bashkim Bakiu

Marija Dimitrovska

Admir Brava

Instituti për Hulumtimin e Politikave dhe Qeverisje të Mirë - Shkup

Shkup, Mars 2016

1. VIZIONI

Analiza e implementimit të arsimit të integruar në Republikën e Maqedonisë, faktorët të cilët ndikojnë mbi procesin ose e pamundësojnë implementimin, si dhe analiza e gjendjes momentale në domenin e arsimit të integruar, faktorët të cilët kontribuojnë në aspekt të funksionimit, si dhe roli i pushtetit lokal sa i përket procesit të decentralizimit. Në këtë kontekst, përmes hulumtimit, presim të kuptojmë:

- Cilat janë praktikata e deritanishme të implementimit të projekteve që kanë të bëjnë me arsimin e integruar;
- Me procesin e decentralizimit, komunitetet a ndikojnë me sukses mbi funksionalitetin e arsimit të integruar;
- Sa kontribuojnë organizatat ndërkombëtare për arsimin e integruar;
- Cilat janë rekomandimet të cilat mund të theksohen në lidhje me funksionimin e përmirësuar të arsimit të integruar.

1. Analiza


Gjendja momentale në terren e pasqyruar përmes në disa pikave është si vijon:

1. Segregimi i sistemit arsimor për shumë vjet u manifestua ose u mbështet në mënyrë latente, me qëllim që të shmangen situatat konfliktuale midis nxënësve të grupeve të ndryshme etnike. Kjo ndarje si rrjedhojë e kishte fuqizimin e stereotipave dhe paragjykimëve ndaj Tjetrit tek dy grupet më të mëdha etnike.
2. Implementimi i të drejtave të bashkësive, nga ana e faktorëve politik në shtet, nuk krijoi integrim më të madh. Përkundrazi, ndarjet etnike, veçanërisht midis të rinjve u intensifikuan, ndërsa njohja e Tjetrit mbeti anekdotë.
3. Nxënësit e përkatësive të ndryshme etnike, në kuadër të arsimit fillor dhe të mesëm, mësojnë sipas programeve të ndryshme përmbajtësore mësimore, jo vetëm gjuhësore, në lëndë të caktuara (si për shembull: Histori), të cilat janë kyç për formimin e identitetit të tyre dhe përcaktimin e raportit të tyre me pjesëtarët e tjerë të shoqërisë, të përkatësisë së njëjtë ose të ndryshme kulturore.
4. Ekziston Strategji e cila parashikon reforma dhe aktivitete në pesë sfera të veprimit, me qëllim të realizimit të integritetit ndëretnik në sistemin arsimor, por ajo realizohet pjesërisht.
5. Një numër i madh i shkollave fillore të cilat zyrtarisht udhëhiqen si dygjuhësore ose tri-gjuhësore nuk mundësojnë kontakt të drejtpërdrejtë midis nxënësve të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore.
6. Pjesa më e madhe e mësimdhënësve nuk janë të përgatitur në mënyrë adekuate për të punuar me fëmijë dhe prindër të bashkësive të ndryshme shoqërore dhe kulturore.

7. Mungesë e aktiviteteve shkollore dhe jashtëshkollore në cilat marrin pjesë të rinjtë me kultura të ndryshme. Deri më tani, nga ana e institucioneve shtetërore, janë bërë përpjekje minimale për përmirësimin e këtyre gjendjeve.
8. Ndikim i fuqishëm i kanaleve joformale dhe informale të arsimit (familja, bashkësia lokale, komuniteti fetar, mediat, partitë politike).
9. Strukturat politike në praktikë nuk i konfirmojnë objektivat e deklaruara inhereente të rregullimit pedagogjik dhe të arsimit në përgjithësi.

Ky dokument bazohet mbi analizën e dokumenteve, të politikave publike dhe hulumtimeve të tjera përmes desk-hulumtimeve dhe realizimit të intervistave në terren.

Objekt i analizës ishin aktet ligjore dhe nënligjore, marrëveshjet, hulumtimet dhe raportet e organizatave relevante vendase dhe ndërkombëtare, si dhe punimet dhe hulumtimet nga ekspertë vendas dhe të huaj, si dhe intervistat të cilat u zhvilluan me përfaqësues të institucioneve të pushtetit qendror dhe lokal, siç janë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, përfaqësuesit e Komisionit për Arsimin e Integruar, përfaqësues të Qytetit të Shkupit, komunës së Tetovës, Kumanovës, Tearcës, si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare.



Analiza PESTLE

Ndikimi politik – strukturat politike shpeshherë nuk kanë kontinuitet në veprimet e tyre dhe deklaratat e tyre. Ekziston standard i dyfishtë gjatë veprimit të tyre. Në situata të caktuara ata deklarojnë se janë të interesuar për integrimin e bashkësive në arsim, ndërsa në disa raste, për

qëllime ditore politike japin deklarata të fuqishme nacionaliste, të cilat kanë ndikim të madh në shoqëri dhe e minojnë tërë procesin.

Ndikimi ekonomik – AIN është proces kompleks, kërkon resurse të konsiderueshme financiare. Shteti nuk është i interesuar që financiarisht ta mbështes këtë proces.

Ndikimi social – arsimi i integruar mund të kontribuojë për bashkëjetesë, inkluzion, njohjen e diversiteteve, zhvillimin dhe ngritjen e kapitalit social.

Ndikimi teknologjik – teknologjitë e reja mund të ndikojnë që fëmijët e bashkësive të ndryshme etnike të njihen mes vete, por edhe të largohen akoma më shumë, duke e pasur parasysh se aty kanë qasje në materiale të ndryshme të cilët promovojnë ksenofobi dhe urrejtje etnike.

Ndikimi juridik – Ligjet janë në frymën e AIN, por në terren nuk praktikohen tërësisht.

Mjedisi jetësor – Në AIN, mes tjerash, janë parashikuar edhe aktivitete nga bashkësi të ndryshme etnike në mjedisin jetësor dhe për mjedisin jetësor.

2. Të shikosh përpara

Skenarë dhe rreziqe

Skenar i dëshiruar:

- Inkorporimi dhe implementimi i sistemit të evaluimit të proceseve të deritanishme reformuese në arsimin fillor dhe të mesëm në fushën e arsimit të integruar;
- Precizimi i mekanizmave për promovimin e parimeve të respektit, tolerancës dhe pranimit të legjislacionit që ka të bëjë me arsimin në të gjitha nivelet;
- Të ketë përmbajtje të detyrueshme, të cilat kanë të bëjnë me thellimin e njohjes së Tjetrit dhe promovimin e interkulturalizmit në plan-programet mësimore (për shembull, lëndët: Histori, gjuhë amtare, Atdheu ynë, Vallet dhe vallëzimet popullore, Hulumtimi i vendlindjes për arsimin fillor);
- Të vendosen mekanizma për trajnimin e kuadrit arsimor në kuadër të arsimit formal dhe mekanizma për evaluimin e zbatimit të këtyre informatave në procesin edukativo-arsimor;
- Të vendosen mekanizma për promovimin e mësimin të gjuhës së Tjetrit (gara dhe bursa) në arsimin fillor dhe të mesëm;
- Vazhdimi i promovimi të bashkëpunimit midis kuadrit mësimor dhe shkollave të cilët mësimin e realizojnë në gjuhë të ndryshme (aktivitete jashtë-mësimore, ekskursione dhe festa të përbashkëta);



- Në shkollat shumë - gjuhësore të shmangen barrierat fizike midis nxënësve të kulturave të ndryshme (mësim në objekte të ndryshme, turne të ndryshme dhe ngjashëm);
- Krijimi i paraleleve në të cilat mësimi do të zhvillohet në dy ose tri gjuhë;
- Politika e arsimit të integruar të menaxhohet nga ana e komunave, të cilat kanë njohuri më të thella për gjendjet dhe problemet në nivel lokal;
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës të formojë zëra të veçantë për arsimin e integruar gjatë shpërndarjes së mjeteve financiare përmes bllok dotacioneve;
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja e Zhvillimit të Arsimit duhet të ndërmarrin masa për largimin e teksteve dhe librave shkollorë, të cilët krijojnë stereotipa dhe paragjykime;
- Në sferën e arsimit të lartë të krijohen mekanizma për promovimin e bashkëpunimit midis universiteteve, të cilët mësimin e zhvillojnë në gjuhë të ndryshme (projekte të përbashkëta shkencore-kërkimore, konferenca shkencore dhe ngjashëm).

Rreziqe:

ndikimi		Rreziku financiar	Rreziku politik
		Rreziku administrativ	
		Rreziku i komunikimit	
Besueshmëria			

Rreziku financiar – niveli: i lartë – Nëse nuk ka resurse financiare për t’u financuar ky Projekt besueshmëria është shumë e madhe që ky projekt të dështojë.

Rreziku politik – niveli: i lartë. Pa vullnet serioz dhe të sigurtë politik, procesi i AIN nuk ka gjasa të realizohet. Vullneti politik dhe diskursi politik madje mund të ndikojnë shumë mbi zhvillimin, përkatësisht rrezikimin e procesit politik.

Rreziku administrativ – niveli: i mesëm. Në vazhdimësi duhet të avancohet dhe trajnohet kuadri mësimdhënës për realizimin më me sukses të integrimit ndëretnik në arsim.

Rreziku i komunikimit – niveli: i ulët. Nxënësit e një grupi etnik dëshirojnë të komunikojnë me nxënësit e grupit tjetër etnik, megjithatë ata kanë nevojë vetëm për stimulim.

Ndikimi

Opsioni për arritjen e epilogut/rezultatit të dëshiruar, i përshkruar si skenar i dëshirueshëm, efektiviteti i tij, konsistenca, shpenzimi dhe realizimi ndërlidhen edhe me rreziqet e mjedisit me ndikimet e jashtme.

Për realizimin e ndikimit mbi bartësit kryesor të vendimeve, nevojitet shfrytëzimi i mekanizmave për përfaqësim dhe lobim, duke filluar me: prezantimin e konstatimeve dhe rekomandimeve për politikanët në lidhje me suksesin e AIN, stimulimin e sektorit joqeveritar për veprimin e mëtutjeshëm në projekte, që kanë të bëjnë me arsimin e integruar ndëretnik dhe ndryshimin e sistemit të financimit të pushtetit lokal, me ç'rast në procesin e krijimit të dotacioneve për arsim në pushtetin lokal të inkorporohet kategori ose koeficient i veçantë për arsimin ndëretnik. Kjo do t'i stimulonte edhe vet komunat dhe shkollat që të punojnë më shumë në këtë drejtim. Gjithashtu, duhet të ndikohet tek pushteti lokal që fondet, të cilat i ka në dispozicion për sektorin joqeveritar, më shumë t'i ridedikojë në këtë drejtim.

Bërja e ndryshimit: Si të sigurohemi se funksionojnë politikat e propozuara publike?

Mënyrat, me të cilat mund të ndikojmë mbi palët e interesit në këtë proces, përfshijnë shkëmbimin e informatave, krijimin e mekanizmave të kontrollit nga më shumë anë, duke filluar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, përmes përgatitjes së analizave, lobimit dhe monitorimit të procesit të implementimit të politikave që kanë të bëjnë me arsimin e integruar.

Vlerësimi dhe nxënia: Si duket sukcesi? Si mund t'i shfrytëzojmë leksionet të cilat i kemi mësuar?

Ekzistojnë modele shumë të suksesshme të cilat mund t'i marrim si shembull. Vet fryma evropiane dhe vlera evropiane si objektiv e ka veprimin e përbashkët të grupeve të ndryshme etnike. Në Republikën e Maqedonisë janë iniciuar me vonesë reforma të cilat duhet ta përforcojnë kohezionin midis pjesëtarëve të grupeve të ndryshme kulturore.

Ekziston një përmirësim i gjendjeve sa i përket arsimit të integruar (detektimi i rëndësisë së tij dhe inicimi i reformave për arritjen e tij). Problemet, të cilat ekzistojnë janë më shumë të natyrës sistematike dhe politike.

Në këtë drejtim, politikat arsimore duhet të hartohen në përputhje me politikat e përgjithshme të integritit, si pjesë e tyre.

Me këto ndryshime të propozuara ofrohen mundësi për veprim në dy nivele ndaj këtij procesi. Idetë e propozuara ofrojnë zgjidhje të mundshme për zgjidhje sistematike të problemeve, por



edhe për përmirësimin e punës në terren, përmes involvimit të drejtpërdrejtë të nxënësve, prindërve, kuadrit mësimor dhe shkollave.